



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1464 / prot.
8

Tiranë më 29.12.2017

VENDIM

Nr. 105, datë 29.12.2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Alpha Bank Albania".

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 288, datë 09.11.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Alpha Bank Albania" me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga një subjekt të dhënash në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua se:

1. Kontrolluesi "Alpha Bank Albania" ka si objekt të veprimtarisë tregtare atë të ofrimit të shërbimeve financiare. Në lidhje me ankesën e paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga znj. _____, u konstatua se, ankuesja rezultonte e raportuar nga kontrolluesi në regjistrin e kredive të Bankës së Shqipërisë, raportim për shkakun e të cilit ajo nuk ka pasur dijeni. Në këto kushte i është drejtuar kontrolluesit Alpha Bank Albania me kërkesën e datës 19.09.2016 për t'u informuar mbi arsyet e këtij raportimi. Të njëjtën kërkesë ia ka drejtuar edhe kontrolluesit Bankës së Shqipërisë.
2. Nga verifikimi i kryer rezultoi se regjistrin e kredive e mban dhe e administron Banka e Shqipërisë me qëllim trajtimin e centralizuar dhe shpërndarjen e informacionit të regjistruar në të, në funksion të ushtrimit të procesit të mbikëqyrjes dhe administrimit optimal të rrezikut të kredisë nga subjektet e mbikëqyrura prej saj. Raportimi dhe përditësimi i të dhënave, realizohet nga vetë

raportuesit e të dhënave (bankat e nivelit të dytë dhe institucione të tjera financiare), në mënyrë periodike. Institucionet financiare, të cilat raportojnë në regjistrin e kredive, mbajnë përgjegjësi për saktësinë e të dhënave të raportuara.

3. Më datë 07.10.2016 kontrolluesi "Alpha Bank Albania" ka komunikuar me ankuesen nëpërmjet postës elektronike dhe ka pranuar se raportimi kishte ndodhur për shkak të një gabimi gjatë përpunimit të të dhënave të saj si dhe i ka bërë me dije që kishte marrë masat e nevojshme për korrigjimin e të dhënave të pasakta.
4. Pas një periudhe 1 vjeçare, ankuesja ka aplikuar për rinovimin e një overdrafti pranë një banke tjetër të nivelit të dytë, aplikimi i është refuzuar pas verifikimit që kjo bankë ka bërë në regjistrin e kredive pranë Bankës së Shqipërisë. Nga verifikimi i kryer gjatë hetimit administrativ rezultoi se kontrolluesi kishte raportuar përsëri ankuesen në regjistrin e kredive të Bankës së Shqipërisë. Kontrolluesi "Alpha Bank Albania", pavarësisht komunikimit me ankuesen një vit më parë, nuk kishte marrë masat e duhura për të fshirë/korrigjuar të dhënat e pasakta të subjektit të të dhënave znj.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin (datë 07.12.2017), si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në datën 27.12.2017, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit, është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesin e kontrolluesit, lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ.

Përfaqësuesi i kontrolluesit gjatë seancës dëgjimore parashtroi këto pretendime lidhur me konstatimet e grupit të inspektimit:

"Në lidhje me pasaktësinë e konstatuar një vit më vonë (pas 07.10.2016) për statusin e kredisë ju bëjmë me dije se ajo ka ardhur për shkak të një gabimi teknik të cilin banka e ka pranuar dhe ka vijuar me korrigjimin përkatës.

Banka beson se statusi i një kredie nuk është një e dhënë personale. Ndaj gabimi i mësipërm nuk mund të jetë subjekt i ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe nuk përbën shkelje të neneve të cituar në procesverbalin e datës 07.12.2017".

Pavarësisht qëndrimit të përfaqësuesit të kontrolluesit, Zyra e Komisionerit vlerëson se të dhënat e përpunuara nga kontrolluesi janë të dhëna personale sipas parashikimit të pikës 1 të nenit 3, të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, i cili cilëson si të dhënë personale çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Referuar pretendimeve dhe dokumenteve të paraqitura si provë nga kontrolluesi, Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo subjekt i të dhënave ka të drejtë të kërkojë bllokimin, korigjimin ose fshirjen e të dhënave, kur vihet në dijeni se të dhënat rreth tij nuk janë të rregullta, të vërteta, të plota ose janë përpunuar dhe mbledhur në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar.

Gjithashtu, është detyrim i kontrolluesit të kryej vetë ose me kërkesë të subjektit të të dhënave bllokimin, korigjimin ose fshirjen e të dhënave personale, kur vëren se të dhënat janë të parregullta, të pavërteta, të paplota ose janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e ligjit të mësipërm.

Zyra e Komisionerit vlerëson se mos kryerja e korigjimit dhe fshirjes së të dhënave të ankueses dhe deklarimi i pasaktë i tyre në regjistrin e kredive të Bankës së Shqipërisë, në mënyrë të përsëritur nga ana e kontrolluesit “Alpha Bank Albania”, ka sjellë pasoja për subjektin e të dhënave dhe është në kundërshtim me nenin 19 të Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar si dhe ka cënuar parimin e sanksionuar në nenin 5/1/ç të ligjit.

Sa më sipër, shkelja e konstatuar gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronja “a” e Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë, si më poshtë:

a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10.000 deri në 500.000 lekë;

Kontrolluesi “Alpha Bank Albania”, në formën ligjore të aktivitetit të tij tregtar është person juridik dhe sipas nenit 39/2 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, dënohet me dyfishin e gjobës të përcaktuar më sipër.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit mban parasysh faktin se shkelja e konstatuar është serioze, ajo lidhet me garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale, saktësinë që të dhënat duhet të kenë dhe, kur është e nevojshme, duhet të përditësohen, duke ndërmarrë çdo hap të arsyeshëm për të fshirë apo korigjuar të dhëna të pasakta apo të paplota, në lidhje me qëllimin për të cilin janë mbledhur apo për të cilin përpunohen më tej.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5/1/ ç, 29, 30, 31, 39/1/a, 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit “Alpha Bank Albania” me gjobë, në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 5/1/ç të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.
2. Gjoba arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthçhet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 23.12.2017

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

